KOMUNIKATË PËR WEB

Sigurimi i mbrojtjes së të dhënave personale gjatë Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë

16.01.2024

Në ambientet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) u mbajt takim me Komisioneren e Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP), znj. Krenare Sogojeva Dermaku dhe Drejtoren e Përgjithshme të AIP-së, Lumnije Demi.

Takimin e udhëhoqi U.d. Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, z. Avni Kastrati, i cili i njoftoi të pranishmet rreth rrjedhës së procesit të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë (REKOS 2024) që planifikohet të realizohet nga 05 Prill deri më 17 Maj 2024.

Tema kryesore për diskutim e këtij takimi ishte sigurimi i mbrojtjes së të dhënave personale të qytetarëve gjatë Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë (REKOS 2024 në koordinim të përbashkët ndërmjet dy institucioneve. Gjithashtu, në takim u diskutua edhe për realizimin e trajnimeve për ekipet e Regjistrimit të Popullsisë, ku njëra ndër komponentët e rëndësishëm të projektit do të jetë sigurimi se ky proces do të garantojë se të dhënat personale të qytetarëve do të mbrohen sipas legjislacionit në fuqi.